

LIGJ
Nr.8328, datë 16.4.1998

**PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË
PARABURGOSURVE**

(Ndryshuar me ligjin nr.8758, datë 26.3.2001 botuar në FZ nr.15)
(Ndryshuar me ligjin nr.9071, datë 22.5.2003 botuar në FZ nr.53)
(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008 botuar në FZ nr.44)
(Ndryshuar me ligjin nr.10 087, datë 26.2.2009 botuar në FZ nr.32)
(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014, botuar në FZ nr. 67)

I përditësuar

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
OBJEKTI

Neni 1

Ky ligj përcakton të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurit dhe të dënuarve me burgim, kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente.

Neni 2

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)
(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

I nënshtrohen rregullave të këtij ligji të paraburgosurit dhe të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë të gjykatave shqiptare dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare edhe të gjykatave të huaja, duke respektuar kërkesat përkatëse procedurale.

I nënshtrohen rregullave të këtij ligji të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit me vendim të formës së prerë, shtetas shqiptarë, të huaj dhe personat pa shtetësi.

Neni 3

(Shfuqizuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008, neni 3)

Neni 4

Vuajtja e dënimeve me burgim bëhet vetëm në vendet e caktuara posaçërisht sipas këtij ligji. Ministri i Drejtësisë në raste të gjendjes së jashtëzakonshme, të rrezikimit nga forca madhore, të kryerjes së punimeve të rëndësishme, si dhe kur rrezikohet jeta dhe shëndeti i të paraburgosurit dhe të dënuarve, mund të urdhërojë që vuajtja e dënimit të bëhet përkohësisht në vende të tjera të përshtatshme.

KREU II PARIMET THEMELORE

Neni 5

Respektimi i të drejtave të njeriut

(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindjeje politike, fetare ose filozofike, orientimi seksual, identiteti gjinor gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, shtetësie ose përkatësie në një grup të caktuar ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim.

Të miturit e paraburgosur dhe të dënuar trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre. Trajtimi mbështetet në interesin më të lartë të fëmijës, të integritetit shoqëror, edukimit dhe parandalimit të rifutjes në krim.

Gratë e paraburgosura dhe të dënuara trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore dhe pa diskriminim, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi që dënohen sipas ligjeve në fuqi.

Të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohej trajtim i barabartë, jodiskriminues, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre bëhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me çrregullime të shëndetit mendor.

Të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar u garantohej liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, trajtimi jodiskriminues i ndonjë lloji, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit e huaj ose pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike, me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, gjatë transferimit dhe pas lirimit.

Masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për respektimin e lirive dhe të drejtave të grupeve të veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve nuk konsiderohen diskriminim, sipas këtij ligji.

Neni 5/1

Parandalimi i dhunës dhe trajtimi i viktimave

(Shtuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Të paraburgosurve dhe të dënuarve që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, i ofrohen menjëherë masa mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime ligjore me qëllim rehabilitimin e tyre.

Në rastet e dhunës ndaj grave dhe të miturave, mbahen parasysh nevojat specifike gjinore të tyre.

Në raste të përdorimit të dhunës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, autoritetet e institucionit, në çdo rast, mundësojnë fillimin e menjëhershëm të një hetimi të pavarur, nga strukturat dhe organet kompetente të ngarkuara me ligj, duke respektuar parimin e privatësisë, mbrojtjes dhe sigurisë personale.

Neni 6

Kufizimi individual i të drejtave

Të drejtat e të paraburgosurit dhe të dënuarve, sipas këtij ligji, mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht për shkelje të ligjit ose rregullave të brendshme, vetëm në rastet dhe sipas kriterëve të parashikuara në këtë ligj.

Neni 7

Kufizimi në grup i të drejtave

Të drejtat e të paraburgosurit dhe të dënuarve mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht në grup, me urdhër të ministrit të Drejtësisë vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, për shkak të forcës madhore, të kryerjes së punimeve të rëndësishme në institucion ose kur ka rrezik për jetën dhe shëndetin e të paraburgosurit dhe të dënuarve në atë masë dhe për aq kohë sa përcaktohet në urdhër.

Drejtuesi i institucionit dhe në mungesë të tij zëvendësi, për rastet urgjente mund të vendosin kufizime sipas paragrafit të parë të këtij neni dhe jo më vonë se 24 orë të marrë për këtë miratimin e Ministrit të Drejtësisë.

Neni 8

E drejta e kërkesës dhe ankimit

(Shfuqizuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë ligj dhe në mënyrë individuale.

Kërkesat dhe ankesat duhet t'i drejtohen, si rregull, organit kompetent sipas këtij ligji, por të paraburgosurit dhe të dënuarit kur e çmojnë me vend mund t'i drejtohen cilitdo organ shtetëror ose organizatë joqeveritare brenda dhe jashtë vendit.

KREU III TRAJTIMI

Neni 9

Rehabilitimi social dhe riintegrimi

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Trajnimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve synon rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike.

Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas liritimit nga burgu.

Institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale, në bashkëpunim me shërbimin e provës, shërbimet e mirëqenies sociale, organet vendore dhe organizatat jofitimprurëse hartojnë programe riintegrimi prag-lirimi për adresimin e çështjeve gjinore.

Për të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur përgatitja për riintegrim realizohet në bashkëpunim me të miturin, punonjësin social, familjen ose kujdestarin e tij.

Për të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajt dhe personat pa shtetësi, për aq sa është e mundur, mundësohen programe që respektojnë kulturën e tyre.

Neni 10

Individualizimi i trajtimit

(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Trajtimi i të paraburgosurit dhe të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar.

Individualizimi i trajtimit bëhet duke vlerësuar nevojat individuale psikologjike, shoqërore, të moshës, gjinore, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri ose i dënuari, faktorët e riskut dhe motivimin për t'u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion.

Vëzhgimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit, duke bërë përshtatjet e duhura në bashkëpunim me të dënuarin.

Neni 11

Programi dhe realizimi i trajtimit

(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Pas procesit të vlerësimit bëhet programimi i trajtimit, në bashkëpunim me të paraburgosurin ose të dënuarin. Për çdo të paraburgosur dhe të dënuar hartohet plani i riintegrimit, ndërsa për kategoritë e veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve hartohet programi individual i trajtimit duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike të tyre.

Rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psiko-social të të paraburgosurve dhe të dënuarve të mitur, të rinjve 18 deri 21 vjeç, grave, personave me çrregullime të shëndetit mendor, të pasura ose të fituara gjatë burgimit, personave me aftësi të kufizuar, personave me orientim seksual të ndryshëm, personave me sëmundje kronike ose në varësi të drogës, të moshuarve, personave të dënuar me dënime afatgjatë, personave që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi.

Për çdo të mitur të paraburgosur ose të dënuar përgatitet një plan individual rehabilitimi dhe riintegrimi, i cili merr në konsideratë arsimin e tij, vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, dëshirat dhe mundësitë e tij/saj për të ndjekur kurse profesionale ose për të avancuar në arsim.

Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse.

Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës për hartimin, zhvillimin, realizimin e programeve të mbikëqyrjes së të paraburgosurve dhe të të dënuarve bëhet me urdhër të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë. Kontributi i organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë inkurajohet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.

PJESA E DYTË INSTITUCIONET

KREU I LLOJET E INSTITUCIONEVE

Neni 12

Institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale (Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim janë:

Burgu i sigurisë së lartë

Burgu i zakonshëm

Burgu i sigurisë së ulët

Institute të veçanta

Institucion paraburgimi

Krijimi, klasifikimi dhe mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim apo seksioneve të veçanta në këto institucione bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 12/1

(Shtuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

1. Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë publike dhe private.
2. Funksionimi, administrimi, kontraktimi, si dhe rregullat që përcaktojnë elementet e sigurisë në institucionet private të ekzekutimit të vendimeve penale përcaktohen sipas legjislacionit në fuqi dhe me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 12/2

(Shtuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

1. Në institucionet private të ekzekutimit të vendimeve penale vendosen të dënuar, për të cilët është caktuar si masë dënimi në maksimum deri në 5 vjet burgim.
2. Në institucionet private të ekzekutimit të vendimeve penale nuk vendosen të dënuar që, me vendim gjykate, janë caktuar në burg të sigurisë së lartë.

Neni 13

Burgu i sigurisë së lartë

(Shfuqizuar paragrafi i dytë me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008,)

(Ndryshuar fjalia e dytë e paragrafit të dytë me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Burgu i sigurisë së lartë është institucioni ku ekzekutohen vendimet me burgim për subjekte të krimit të organizuar dhe të dënuar të tjerë të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime e sjellje që bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera.

Vendosja e të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë kur nuk është shprehur gjykata me vendim, bëhet me kërkesë të prokurorit tek ajo gjykatë. Ndryshimi i klasifikimit të sigurisë nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë në institucione të tjera të ekzekutimit të dënimit bëhet me kërkesë të prokurorit, të dënuarit ose përfaqësuesit të tij ligjor, pranë gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet institucioni. Transferimi nga burgu i sigurisë së lartë në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit bëhet me kërkesë të vetë të dënuarit, pranë gjykatës ku ndodhet institucioni.

Në burgjet e sigurisë së lartë, vihen kufizime në të drejtat e të dënuarit, në rastet dhe sipas kriterëve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Në burgjet e kategorive të tjera me urdhër të ministrit të Drejtësisë mund të krijohen seksione të burgut të sigurisë së lartë, në të cilat zbatohen rregullat e mësipërme.

Neni 14

Burgu i sigurisë së zakonshme

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Burgjet e sigurisë së zakonshme janë institucionet, ku vuhet dënimi nga të gjithë të dënuarit, me përjashtim të atyre, që vendosen në burgjet e sigurisë së lartë, në burgjet e sigurisë së ulët dhe në institucione të veçanta.

Kur gjykata, në vendimin me burgim, nuk është shprehur për llojin e institucionit, ku do të vuhet dënimi, të dënuarit vendosen në një burg të sigurisë së zakonshme. Shpërndarja dhe transferimi i të dënuarve në burgjet e sigurisë së zakonshme bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, në burgjet e sigurisë së zakonshme mund të krijohen seksione të sigurisë së ulët.

Neni 15

Burgu i sigurisë së ulët

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Burgjet e sigurisë së ulët janë institucionet, ku vuhet dënimi për të dënuarit për kundërvajtje penale, për vepra penale nga pakujdesia dhe për vepra të tjera penale, dënimi i të cilave nuk i kalon 5 vjet burgim.

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me kërkesë të drejtorit të institucionit ku i dënuari po vuan dënimin, apo me nismën e vet, për të dënuarit që u ka mbetur për të vuajtur më pak se 2 vjet burgim dhe kanë respektuar rregulloren e brendshme të institucionit, mund të vendosë transferimin e tyre në një burg të sigurisë së ulët.

Neni 15/1
Institucionet e paraburgimit
(Shtuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Institucionet e paraburgimit janë institucionet, ku mbahen individët, ndaj të cilëve është dhënë nga gjykata masa e sigurimit “arrest në burg”

Neni 16
Institucionet mjekësore të posaçme dhe seksionet mjekësore të posaçme
(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Institucionet mjekësore të posaçme jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale shërbejnë për mjekimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor.

Vendosja e personave në institucionet mjekësore të veçanta, jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës.

Vendosja e personave në seksione mjekësore të posaçme kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës ose të urdhrorit të ekzekutimit të prokurorit. Në rastet që nuk presin, vendosja e personit të paraburgosur ose të dënuar urdhërohet nga drejtori i institucionit ku ndodhet i paraburgosuri ose i dënuari, duke vënë në dijeni menjëherë prokurorin.

Dalja nga institucionet mjekësore të posaçme bëhet me vendim të gjykatës në vijim të propozimit të drejtuesit të institucionit, kërkesës së të paraburgosurit dhe të dënuarit ose kujdestarit ligjor të tij, si dhe me iniciativën e gjykatës, duke respektuar afatin maksimal të një viti për rivlerësimin e gjendjes së personit.

Për vendosjen, refuzimin e vendosjes, daljen ose refuzimin e daljes nga institucionet mjekësore të posaçme, i paraburgosuri dhe i dënuari, mbrojtësi ose kujdestari i tij kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Trajtimi në seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet për aq kohë sa gjykata nuk shprehet për trajtimin e tyre në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për shëndetit mendor.

Në institucionet mjekësore të posaçme dhe seksionet mjekësore të posaçme respektohen të gjitha të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve, sipas këtij ligji, si dhe të drejtat e pacientit.

Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë me udhëzim të përbashkët përcaktojnë mënyrën e zbatimit të procedurave që lidhen me trajtimin e kësaj kategorie personash.

Neni 16/1
Vendosja e personave bashkëpunëtorë të drejtësisë
(Shtuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale krijohen seksione të veçanta për vendosjen e personave, të paraburgosur ose të dënuar, që gëzojnë statusin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Shtetit marrin masa për sigurimin e jetës së personit dhe realizimin e programit të trajtimit individual të tij.

Neni 17

Vendet e dënimit për gratë dhe të miturit

Gratë dhe të miturit rregullisht e vuajnë dënimin në institucione të posaçme vetëm për to dhe në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera sipas kriterëve të këtij ligji.

Nënave u lejoheq që të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç. Për kujdesin dhe asistencën ndaj këtyre fëmijëve funksionojnë çerdhe të posaçme.

Neni 18

Rregullorja e brendshme e institucioneve

Çdo institucion ka rregulloren e brendshme, të dalë mbi bazë të rregullores së burgjeve, që përcakton organizimin, disiplinën e brendshme dhe kërkesat e trajtimit në kushtet e institucionit.

Rregullorja e brendshme përgatitet nga një komision i caktuar dhe i kryesuar nga drejtori i institucionit dhe miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

KREU II

ORGANET DREJTUESE TË BURGJEVE

(Ndryshuar titulli me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Neni 19

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

(Shtuar dy paragrafë në fund të nenit me ligjin nr.10 087, datë 26.2.2009)

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, të kryerjes së dënimit dhe të trajtimit të të ndaluarve, të arrestuarve e të dënuarve me burgim.

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të administratës civile në Drejtorinë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët nuk bëjnë pjesë në strukturat e Policisë së Burgjeve, si dhe të punonjësve të administratës civile, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, rregullohen sipas legjislacionit të shërbimit civil.

Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 20

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale janë institucione në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe kanë për detyrë pritjen, sistemimin, trajtimin dhe rehabilitimin social të të burgosurve.

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale drejtohen, kontrollohen dhe përfaqësohen nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Neni 21

Personeli i institucionit

(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

Personeli i institucionit realizon zbatimin e programit të trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve, sipas detyrave të caktuara.

Në përmbushjen e detyrave të tij, personeli i institucionit vepron sipas standardeve më të larta personale dhe profesionale, duke përmbushur detyrat në një mënyrë të tillë që të ndikojë pozitivisht tek i paraburgosuri ose i dënuari, si dhe të gëzojë respektin e tyre.

Gjatë zbatimit të detyrave të tij, personeli i institucionit kujdeset dhe mban parasysht nevojat e çdo të paraburgosuri dhe të dënuari për riintegrimin në shoqëri.

Personeli që punon në institucione ose seksione ku janë vendosur të paraburgosur dhe të dënuar, të përmendur në paragrafin e dytë të nenit 11 të këtij ligji, duhet të jetë i specializuar në fushën përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kujdeset për të mundësuar trajnime dhe kualifikime të veçanta në fushat përkatëse.

Personeli në institucion duhet të ketë një balancim të drejtë mes burrave dhe grave dhe të mbajë parasysht nevojat specifike që ka institucioni.

Neni 22

Policia e Burgjeve

(Ndryshuar me ligjin nr.8758, datë 26.3.2001)

(Ndryshuar me ligjin nr.10 087, datë 26.2.2009)

(Ndryshuar me ligjin nr.40/2014, datë 17.4.2014)

1. Policia e Burgjeve ka për mision ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe gjatë transferimeve e shoqërimeve të të paraburgosurve dhe të dënuarve në gjykata e institucione të tjera, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

2. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Policisë së Burgjeve rregullohet me ligj të veçantë.

KREU III

KUSHTET E JETESËS NË INSTITUCION

Neni 23

Ndërtesat

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim duhet të projektohen, të ndërtohen apo të rikonstruktohen, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat për një jetë normale. Ato duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, si dhe të plotësojnë kërkesat individuale të të dënuarve apo të paraburgosurve.

Rregullat dhe kriteret e hollësishme për kushtet teknike, që duhet të plotësojnë ndërtesat e reja të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe të ministrit që mbulon fushën e ndërtimit.

Neni 24

Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes

Mjediset, në të cilat jetojnë të paraburgosurit dhe të dënuarit, duhet të kenë hapësira të mjaftueshme, me ndriçim të nevojshëm natyror dhe artificial, për të bërë të mundur qëndrimin, punën dhe çlodhjen aktive, të ajrosura dhe të pajisura me shërbimet higjienike. Atje ku e kërkojnë kushtet klimatike duhet të sigurohet edhe ngrohja e mjediseve.

Kur nuk është e mundur të sigurohet fjetja në dhoma individuale, caktimi i të paraburgosurit dhe të dënuarve në të njëjtën dhomë duhet të bëhet në mënyrë të tillë, që të shmangen konfliktet dhe ndikimet negative të ndërsjella. Për këtë qëllim përdoren kriteret e grupmoshave, të llojit të veprave penale të kryera dhe të veçorive instelektuale e psikike të të dënuarve.

Për çdo të paraburgosurit dhe të dënuar sigurohet shtrat i veçantë dhe një komplet i përshtatshëm fjetjeje.

Kuotat minimale për sipërfaqet, vëllimet, ndriçimin dhe ajrimin e mjediseve për të paraburgosurit dhe të dënuarit, caktohen në rregulloren e burgjeve, sipas rekomandimeve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Neni 25

Veshja dhe pajisjet

Çdo të paraburgosurit dhe të dënuari i sigurohet veshmbathje dhe pajisje të tjera individuale në sasi të mjaftueshme, në gjendje të mirë dhe të pastra, të tilla që të sigurojnë plotësimin e kërkesave normale të jetesës.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të mbajnë me leje të administratës, veshmbathje dhe sende të përdorimit vetjak, të cilat duhet të jenë të pastra dhe të përshtatshme, si dhe të objekteve që kanë një vlerë të veçantë morale ose personale.

Neni 26

Higjiena vetjake dhe e mjedisit

Të paraburgosurit dhe të dënuarit i sigurohen mjediset, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për pastërtinë vetjake, në përpjesëtim me numrin e përdoruesve, që të garantojë në mënyrë sa më optimale higjienën vetjake.

Çdo institucion siguron shërbime periodike të pastrimit të mjediseve, veshmbathjes dhe pajisjeve vetjake, si dhe të qethjes dhe të rruajtjes.

Higjiena vetjake, qethja dhe rruajtja mund të bëhen me detyrim vetëm për arsye të veçanta higjieno-sanitare, sipas kërkesës së shërbimit mjekësor dhe me urdhër të drejtorit të institucionit.

Neni 27
Ushqimi

Të paraburgosurit dhe të dënuarve u sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, punën, klimën dhe stinën.

Ushqimi përgatitet dhe jepet si rregull në mjedise të caktuara për këtë qëllim. Me leje të drejtorit të institucionit, në raste të veçanta, të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të përgatisin dhe të konsumojnë ushqimin individualisht.

Norma e ushqimit ditor përcaktohet nga tabelat përkatëse të miratuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë.

Administrata e institucionit pranon ushqime tërësisht ose pjesërisht për të paraburgosurit dhe të dënuarit ose i siguron ato me shpenzimet e tij duke respektuar kufijtë e rregullores së brendshme.

Të paraburgosurit dhe të dënuarve duhet t'u sigurohet në vazhdimësi ujë i pijshëm.

Neni 28
Koha e ajrimit

*(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)
(Shtuar tre paragrafët e fundit me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)*

Të paraburgosurit dhe të dënuarit që nuk punojnë jashtë dhe të gjithë të dënuarit e tjerë, në ditët që nuk punohet, kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim në mjedise të hapura jo më pak se 2 orë në ditë.

Kjo periudhë kohe mund të reduktohet, por jo më pak se 1 orë në ditë për shkaqe të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër të drejtorit të institucionit.

Ajrimi në mjedise të hapura bëhet në grupe, përveç rasteve të parashikuara në nenin 53 shkronjat “c”, “ç” dhe “d”.

Të dënuarit e mitur kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim, jo më pak se 3 orë në ditë, përveç kohës për veprimtari social-edukative. Ajrimi për këtë kategori kryhet veçmas nga të rriturit.

Kjo periudhë kohe mund të reduktohet, por jo më pak se 2 orë në ditë, për shkaqe të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër të drejtorit të institucionit.

Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mundëson infrastrukturën e përshtatshme në rastet kur kushtet atmosferike janë jo të favorshme për kryerjen e ajrimit nga të dënuarit.

Neni 29
Shërbimi shëndetësor
(Shfuqizuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

PJESA E TRETË
PRANIMI DHE TRAJTIMI I TË DËNUARVE NË INSTITUCION

KREU I
PRANIMI

Neni 30

Pranimi në institucion

(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Në çdo institucion krijohet komisioni i pritjes për të pranuar të sapoardhurit. Komisioni informon të paraburgosurin dhe të dënuarin në një gjuhë të kuptueshme për rregulloren e institucionit, të drejtat dhe detyrimet e tij, të drejtat e tij për këshillim e ndihmë ligjore, rregullat e procedurat për paraqitjen e kërkesave e të ankesave.

Autoritetet e institucionit i pajisin menjëherë të paraburgosurit dhe të dënuarit me informacion të shkruar për rregullat në institucion, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, të huaj ose persona pa shtetësi, pajisen me informacion me gojë dhe me shkrim, në gjuhën që e kuptojnë, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucion. I dënuari ka të drejtë të mbajë informacionin me shkrim për vete.

Menjëherë pas pranimit, drejtuesit e institucionit i mundësojnë të paraburgosurit dhe të dënuarit të huaj njoftimin e familjes, këshilltarit ligjor, përfaqësuesit konsullor ose organizatës kompetente që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Shtetasve të huaj, që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në vend, refugjatëve ose personave pa shtetësi u mundësohet komunikimi me përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbrojnë interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar, detyra e të cilit është mbrojtja e interesave të këtyre personave.

Pas momentit të pranimit në institucion, të sapoardhurit menjëherë duhet t'i nënshtrohen një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e plagëve dhe dëmtimeve në kohën e duhur.

Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuara në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet e të sapoardhurit rreth rrethanave të shkaktuara.

Mjeku, në rast se i kërkohet, duhet të pajisë të sapoardhurin me një certifikatë mjekësore, e cila shpjegon gjendjen e lëndimeve dhe rrethanat e tjera.

Mbi bazën e dokumentacionit shoqërues, të shpjegimeve verbale e të formularit të vlerësimit të riskut, vlerësohen të dhënat individuale të të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me personalitetin e tij.

Mbi bazën e këtyre të dhënave përpilohet regjistri i komisionit të pritjes, dokumentacioni përkatës, sipas shërbimeve dhe programohet në vazhdim trajtimi individual për të paraburgosurin dhe të dënuarin.

Neni 31

Diferencimi i institucioneve për qëllime trajtimi caktimi dhe grupimi i të dënuarve

Institucionet dhe seksionet e veçanta janë të organizuara sipas nevojave të trajtimit individual ose në grup të të dënuarve.

Numri i të dënuarve në institucione dhe në seksione përgjithësisht, sistemimi dhe aktivizimi i tyre posaçërisht janë të kufizuara në atë masë që të favorizojnë trajtimin e individualizuar.

Lejohet pranimi i të dënuarve në veprimtari të veçanta, të organizuara në institucione ose seksione të një kategorie të ndryshme nga ato ku janë caktuar, me përjashtim të atyre të sigurisë së lartë.

Grupimi i të dënuarve brenda institucioneve të veçanta bëhet duke pasur parasysh mundësinë që ata të përfitojnë nga një trajtim i diferencuar në grup, në përputhje me kërkesat dhe angazhimin e tyre.

Duhet të favorizohet kriteri i caktimit të të dënuarve në institucione pranë vendbanimit të familjeve të tyre.

KREU II DREJTIMET DHE FORMAT E TRAJTIMIT

Neni 32

Trajtimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Trajtimi i të paraburgosurve dhe i të dënuarve bëhet duke siguruar mjediset dhe mjetet e përshtatshme, si dhe në përputhje me të dhënat e personalitetit të tyre.

Objektivat e trajtimit psiko-social synojnë zhvillimin e aftësive e të shprehive individuale për t'u riintegruar në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së të paraburgosurve dhe të dënuarve në programet e arsimimit, formimit profesional, punësimit, veprimtarive kulturore, sportive, këshillimin psikologjik e social.

Trajtimi social-edukativ i të paraburgosurve dhe të dënuarve zhvillohet me anë të veprimeve individuale dhe të veprimtarive formuese. Ai realizohet nga personeli i institucionit, që ka formimin e duhur në fushën përkatëse dhe aftësi profesionale, në bashkëpunim edhe me punonjësit e tjerë të institucionit.

Trajtimi i grupeve të veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve bëhet nga personel i trajnuar për këto kategori.

Komunikimi me botën e jashtme dhe familjen inkurajohen dhe sigurohen sipas programeve individuale dhe grupe.

Neni 33

Shërbimi mjekësor

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Shërbimi mjekësor sigurohet gjatë të gjithë kohës së qëndrimit në institucion, nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe mbulohet nga sigurimi i detyrueshëm i kujdesit shëndetësor, sipas skemës në fuqi pavarësisht nga kërkesat e të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Personat e paraburgosur dhe të dënuarit me burgim përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të ligjit në fuqi, dhe përfitojnë, pa pagesë, të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit shëndetësor, sipas këtij ligji.

Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve.

Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit, në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të kërkojnë që të vizitohen, me shpenzimet e tyre, nga një mjek që duan ata.

Shërbimi shëndetësor duhet të sigurojë:

1. Parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimin e sëmundjeve;
2. Furnizimin me ilaçe dhe pajisje mjekësore në rastet e emergjencës shëndetësore ato kur nuk mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.
3. Profilaksinë për sëmundjet, duke bërë kujdes të veçantë për sëmundjet infektive dhe ato ngjitëse.
4. Sigurimin e higjienës së mjedisit dhe edukimin sanitar të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Çdo institucion ka shërbim shëndetësor e farmaceutik, që i përgjigjet nevojave për parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit të të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit, që dyshohen ose kanë sëmundje ngjitëse, izoloohen menjëherë në mjedise të posaçme.

Në institucionet ku vuajnë dënimin gratë, funksionojnë shërbimet speciale në shërbim të grave shtatzëna dhe të atyre me fëmijë në gji. Personeli mjekësor viziton çdo ditë të paraburgosurit dhe të dënuarit e sëmurë e ato që bëjnë kërkesë me shkrim ose me gojë drejtuar stafit shëndetësor ose personelit të sigurisë në regjim dhe kontrollon, periodikisht, të gjithë të paraburgosurit dhe të dënuarit e tjerë, sipas një grafiku të hartuar nga drejtorja e institucionit. Personeli mjekësor evidenton dhe njofton menjëherë për sëmundjet që kërkojnë trajtim të specializuar.

Për rastet e sëmundjeve ngjitëse ose të sëmundjeve të tjera, diagnostikimi dhe mjekimi i të cilave nuk mund të sigurohen në kushtet e institucionit, të paraburgosurit dhe të dënuarit transferohen në spitalin e burgjeve dhe, kur është e nevojshme, ata transferohen në Qendrën Spitalore Universitare, Tiranë e në institucionet spitalore, në rang qarku apo rrethi, në varësi të saj.

Diagnostikimi dhe mjekimi në këto qendra bëhen sipas një udhëzimi të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe të Ministrisë të Shëndetësisë.

Në raste urgjence, kur rrezikohet jeta e të paraburgosurit dhe të dënuarit, ai transferohet për mjekim në spitalin e burgjeve ose në spitalet rajonale.

Institutet rajonale higjiëno-sanitare vizitojnë, të paktën dy herë në vit, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, për kontrollin e gjendjes higjiëno-sanitare të mjedisëve dhe masat e marra nga shërbimi shëndetësor i institucionit, për parandalimin e sëmundjeve infektive.

Rregullat e hollësishme për mënyrën e ofrimit të kujdesit shëndetësor dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shëndetësore, për personat paraburgosur dhe të dënuar, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Ministrisë të Drejtësisë.

Neni 33/1

Kujdesi shëndetësor për kategori të veçanta

(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Shërbimi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale organizohet pa diskriminim, për shkak të statusit ligjor të personit në institucion ose për ndonjë arsye tjetër që mund të shërbejë për diskriminim.

Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor mbështetet në ligjin për shëndetin mendor. Të dënuarit dhe të paraburgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë seksioneve mjekësore të posaçme të institucioneve ose në qendrën spitalore të burgjeve.

Trajtimi shëndetësor i grave të dënuara dhe të paraburgosura përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor si: praninë e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme ose sëmundjeve të lindura të gjakut; nevojat për kujdesin shëndetësor mendor, përfshirë trajtimet e çrregullimeve posttraumatike, të rrezikut të vetëvrasjes ose vetëdëmtimit; historinë e shëndetit riprodhues; praninë e varësisë të drogës; abuzimin seksual dhe forma të tjera të dhunës që mund të ketë pësuar përpara pranimin në institucion.

Të dënuarve dhe të paraburgosurave të mitura u garantohen programe dhe shërbime specifike me qasje me moshën dhe gjininë. Ato informohen me një gjuhë të kuptueshme për kujdesin shëndetësor, për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, higjienën vetjake, për format e dhunës dhe çdo lloj abuzimi. Gratë dhe të miturat, që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike, seksuale u në nënshtrohen programeve të kujdesit shëndetësor për trajtimin dhe rehabilitimin e tyre.

Të dënuarit dhe të paraburgosurit, që shfaqin shenja të përdorimit të drogës, substancave psikotrope ose alkoolit, apo shfaqin shenja të stresit, trajtohen sipas programeve shëndetësore dhe sociale që zbatohen në shoqërinë jashtë institucionit.

Personat që mbartin sëmundje infektive, virusin e HIV trajtohen në mënyrë jodiskriminuese dhe sipas standardeve që zbatohen për këto kategori në institucionet spitalore.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit me sëmundje kronike ose të moshuar përfitojnë shërbim shëndetësor, sipas standardeve që zbatohen për këto kategori personash pranë institucioneve të specializuara jashtë sistemit të burgjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve merr masa për të mundësuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore të nevojshme në institucione dhe, në pamundësi të tyre, në institucione të specializuara jashtë sistemit të burgjeve.

Neni 34

Punësimi

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

(Shtuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Të gjithë të paraburgosurve dhe të dënuarve u njihet e drejta për të punuar. Puna organizohet nga drejtoria brenda dhe jashtë institucionit duke shfrytëzuar edhe ndihmën e subjekteve të tjera.

Gjatë vuajtjes së dënimit me burgim nuk mund të detyrohen të punojnë të paraburgosurit dhe të dënuarit që kanë plotësuar kushtet për pension pleqërie, që janë invalidë të grupit të parë dhe të dytë, gratë shtatëzana, për aq kohë sa parashikon ligji në fuqi, si dhe personat që nuk janë në gjendje fizike dhe shëndetësore të kryejnë punën që u ofrohet. Të paraburgosurit dhe të dënuarit që kanë probleme psikike mund të vihen në punë kur kjo i shërben qëllimeve terapeutike.

Punësimi i të miturve mbështetet në parimet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet sipas kritereve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Neni 35
Kushtet e punës

Kushtet e punës duhet të jenë si në shoqërinë e lirë, me qëllim që të dënuarit të përfitojnë aftësi profesionale për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit që tregojnë aftësi për veprimtari shkencore, kulturore, artistike ose të artizanatit, mund të lejohen që të ushtrojnë me shpenzimet dhe për llogari të tyre këto veprimtari.

Kohëzgjatja e punës nuk mund të kalojë kufijtë e përcaktuar nga Kodi i Punës.

Puna është me shpërblim dhe përfshihet në vjetërsinë në punë për efekt pensioni.

Neni 36
Caktimi i punës

Objekti i punës duhet t'u përshtatet kërkesave të veçanta të personalitetit të secilit nga të paraburgosurit dhe të dënuarit në perspektivën e riintegritit në shoqëri.

Kur në institucion nuk është e mundur të sigurohet puna për të paraburgosurit dhe të dënuarit, tërësisht ose pjesërisht, mund të sigurohen fronte pune jashtë institucionit, duke aktivizuar të paraburgosurit dhe të dënuarit me kriterin e aftësisë për punë, formimin profesional dhe duke preferuar të paraburgosurit dhe të dënuarit që kanë pasur më pak aktivizim pune.

Në çdo rast, dalja jashtë institucionit dhe kryerja e punës bëhen gjithmonë të shoqëruar nga personeli i institucionit dhe të ruajtur nga policia e burgjeve.

Neni 37
Arsimimi
(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Arsimimi dhe formimi kulturor e profesional bëhet me anë të organizimit të shkollës, e detyrueshme për të miturit, si dhe të kurseve profesionale, sipas simeve në fuqi.

Nxitet kryerja dhe favorizohet ndjekja e studimeve profesionale, duke përdorur kurset me korrespondencë.

Administrata e institucionit inkurajon dhe krijon kushtet për formimin profesional brenda dhe jashtë institucionit.

Kujdes i veçantë i kushtohet formimit kulturor e profesional të të paraburgosurit dhe të dënuarve me moshë nën 25 vjeç.

Të dënuarve dhe të paraburgosurve që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore që nuk kuptojnë ose zotërojnë gjuhën shqipe, të dënuarve të huaj u mundësohen materiale të shkruara në gjuhën e tyre ose në një gjuhë që e kuptojnë më mirë.

Neni 38
Veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive
(Shtuar dy paragrafët e fundit me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Organizimi i veprimtarive kulturore, çlodhëse e sportive duhet të synojë ruajtjen dhe zhvillimin e aftësive fizike, shpirtërore dhe psikike të të paraburgosurit dhe të dënuarve.

Për të dënuarit e mitur hartohet një program i veçantë përfshirjeje në veprimtari kulturore, krijuese e sportive, në bashkëpunim me të miturin.

Administrata e institucionit bashkëpunon me institucionet e tjera, organizatat jofitimprurëse e ato fetare për organizimin e veprimtarive kulturore, krijuese dhe sportive, brenda dhe jashtë institucionit.

Neni 39

Mjediset dhe kushtet materiale të trajtimit

Në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe riedukimit, sipas kërkesave të trajtimit, duhet të sigurohen mjediset dhe mjetet e përshtatshme dhe të nevojshme për zhvillimin e punës, arsimimin shkollor dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër të përbashkët ose individuale.

Institucionet duhet të jenë të pajisura me një bibliotekë librash dhe botime periodike.

Neni 40

Lidhjet me familjen

(Shfuqizuar fjalia e fundit e paragrafit të katërt me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Kujdes i veçantë i kushtohet ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të paraburgosurit dhe të të dënuarve me familjen.

I paraburgosuri dhe i dënuari mund të informojë menjëherë familjarët për futjen e tyre në një institucion ose kur transferohet prej tij.

Në rast vdekjeje ose sëmundjeje të rëndë fizike ose psikike të një të paraburgosurit dhe të dënuari, duhet të njoftohen menjëherë familjarët.

Institucioni njofton menjëherë të paraburgosurit dhe të dënuarin kur vihet në dijeni për vdekjen e të afërmëve të tij.

Për të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur dhe për gratë që kanë fëmijë të mitur, bëhet një program i posaçëm dhe favorizues për lidhjet me familjen.

Neni 41

Takimet, vizitat, korrespondencat dhe informacioni

(Shtuar tre paragrafë me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Të paraburgosurit dhe të dënuarit lejohen që të kenë takime dhe korrespondenca me familjarët dhe persona të tjerë.

Takimet zhvillohen në vende të veçanta nën kontroll shikimi dhe jo dëgjimi nga personeli mbikëqyrës.

Favorizohen veçanërisht takimet me familjarët.

Kur organizimi i institucionit e lejon, të dënuarit mund të autorizohen të rrinë me familjarët përtej kufirit kohor të parashikuar. Sipas kritereve të rregullores së burgjeve vizitat mund të bëhen në vende të rezervuara.

Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale mundëson takime konfidenciale të të paraburgosurve dhe të dënuarve me anëtarët e komisionit mbikëqyrës, mbrojtësin e zgjedhur ose të caktuar kryesisht, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të OJF-ve, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut, të fëmijëve, grave, të rinjve, me të cilat Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Për të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur zbatohet një trajtim favorizues për korrespondencën telefonike dhe takimet me familjarët.

Programet, lloji dhe mënyra e zbatimit të trajtimit për të miturit përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Administrata e institucionit vë në dispozicion të të dënuarve, që nuk i kanë mundësitë, mjetet e nevojshme për korrespondencën.

Korrespondenca telefonike mund të autorizohet në marrëdhëniet me familjarët, në raste të veçanta me të tretët.

Të dënuarit lejohen të mbajnë gazeta, revista e libra që janë në shitje të lirë jashtë dhe të shfrytëzojnë mjete të tjera informacioni të lejuara.

Me kërkesë të prokurorit në rastet e parashikuara në ligj, gjykata lejon kontrollin e korrespondencës së të dënuarit. Kontrolli mund të bëhet nga drejtori i institucionit ose nga persona të autorizuar prej tij në prani të prokurorit. Kërkesa e prokurorit pezullon dorëzimin e korrespondencës.

Neni 42

E drejta e besimit dhe ushtrimi i riteve fetare

Të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtën e besimit dhe të ushtrimit të riteve. Për ushtrimin e riteve, institucioni siguron mjedise të veçanta.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtë të marrin kontakt me përfaqësues të komuniteteve fetare, të caktuar në marrëveshje mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe komuniteteve fetare të njohura ligjërisht.

Neni 43

Hyrja në institucion

(Ndryshuar me ligjin nr. 9071, datë 22.5.2003)

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale mund të vizitohen pa autorizim nga:

Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Zëvendëskryetari i Kuvendit, Zëvendëskryeministri, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm, deputetët, Zëvendësministri i Drejtësisë, Avokati i Popullit, komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe zëvendësit e tij, Drejtori i Policisë së Burgjeve, drejtori dhe inspektorët e kontrollit të brendshëm të burgjeve, anëtarët e komisionit mbikëqyrës të ekzekutimit të vendimeve penale, gjyqtarët dhe prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si dhe avokatët e të burgosurve dhe të paraburgosurve.

Nuk është i nevojshëm autorizimi për ata që shoqërojnë personat e përmendur në paragrafin e mësipërm, por gjithmonë jo më shumë se dy.

Personat e tjerë, që nuk parashikohen në paragrafin e parë, mund të hyjnë në institucion vetëm me autorizim të drejtorit të institucionit.

Këta persona, në rast refuzimi pa shkaqe të arsyeshme të dhënies së autorizimit nga drejtori i institucionit, kanë të drejtë të ankohen te Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Për përfaqësuesit e komuniteteve fetare zbatohen rregullat e parashikuara në nenin 42 të këtij ligji.

PJESA E KATËRT
REGJIMI NË INSTITUCION

KREU I
NORMAT E SJELLJES, ZHDËMTIMI DHE PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE

Neni 44
Normat e sjelljes së të paraburgosurve dhe të dënuarve

Rregullorja e burgjeve dhe ajo e brendshme e institucionit përcaktojnë rregulla lidhur me trajtimin, regjimin dhe sjelljen e të paraburgosurit të dënuarve, duke vendosur kufizime të nevojshme për atë që nuk cenohen kërkesat e këtij ligji dhe synimi për riedukimin e tyre.

Me rastin e pranimit në institucion dhe gjatë vuajtjes së dënimit, të paraburgosurit dhe të dënuarit janë të detyruar të njohin dhe respektojnë rregullat e brendshme, dispozitat që lidhen me të drejtat dhe detyrat e tyre, të trajtimit dhe të disiplinës.

Asnjë të paraburgosuri dhe të dënuari nuk mund t'i caktohen detyra në shërbimet në institucion, që i japin atij një pozicion sundues ose favorizues ndaj të dënuarve të tjerë.

Neni 45
Përgjegjësia për dëmet

Të paraburgosurit dhe të dënuarit detyrohen të kujdesen për sendet e vëna në dispozicion të tyre, si dhe të shmangin çdo lloj dëmtimi të sendeve të të tjerëve.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit që shkaktojnë dëm material ndaj administratës së institucionit ose personave të tjerë, duhet ta dëmshpërblejnë atë.

Neni 46
Izolimi
(Shfuqizuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Neni 47
Kontrolli vetjak
(Shtuar paragrafi i katërt me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Të paraburgosurit dhe të dënuarit i nënshtrohet kontrollit vetjak në çdo rast të hyrjes apo daljes nga institucioni dhe, në raste të tjera, kur ka shkaqe të arsyeshme.

Kontrolli vetjak duhet të bëhet, duke respektuar dinjitetin e të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Kontrolli mund të bëhet vetëm nga persona me të njëjtin seks me të paraburgosurit të dënuarin.

Kontrolli i grave dhe të miturave të paraburgosura ose të dënuara kryhet vetëm nga stafi me të njëjtën gjini, i trajnuar në metoda të përshtatshme kontrolli, në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Me autorizim të drejtorit të institucionit, në rastet dhe mënyrën që parashikohet në rregulloren e burgjeve, mund të bëhen edhe kontrole të anësive.

Neni 48

Shoqërimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve (*Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014*)

Lëvizjet e të dënuarve jashtë institucionit bëhen në një kohë mundësisht sa më të shkurtër, nën shoqërimin Policisë së Burgjeve, sipas rregullave të përcaktuara Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Shoqërimi i grave të dënuara ose të paraburgosura kryhet nga personeli i së njëjtës gjini, ndërsa shoqërimi i të sëmureve kryhet me praninë e stafit mjekësor.

Gjatë lëvizjes tregohet kujdesi i duhur, për të ekspozuar sa më pak të dënuarin ose të paraburgosurin në sytë e njerëzve dhe duke marrë masa mbrojtëse për të siguruar anonimitetin.

Në lëvizjet kolektive është gjithmonë i detyrueshëm përdorimi i prangave ose i mjeteve të tjera shtrënguese.

Neni 49

Kërkesat dhe ankesat (*Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014*)

Pas pranimit në institucion, i paraburgosuri dhe i dënuari informohen nga komisioni i pritjes lidhur me të drejtën për të paraqitur kërkesa ose ankesa, me shkrim ose përjashtimisht me gojë, drejtuar personelit të institucionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrit të Drejtësisë, Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare, OJF-ve vendase dhe të huaja, gjykatës së vendit të ekzekutimit të vendimit penal, prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, si dhe personave të tjerë që vizitojnë institucionin, sipas nenit 43 të këtij ligji.

I paraburgosuri dhe i dënuari informohen për mundësinë e takimeve me drejtorin e institucionit, ose personelin përgjegjës për çështje në interes të tyre ose që përbëjnë shqetësim.

Personeli i autorizuar organizon takime periodike me të paraburgosurin dhe të dënuarin, me qëllim krijimin e mundësive të paraqitjes së kërkesave ose ankesave. Rregullat dhe procedurat lidhur me shpeshësinë, kohën e takimeve dhe mënyrën e zhvillimit të tyre rregullohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Kërkesat ose ankesat, pasi regjistrohen në një regjistër të veçantë, i dorëzohen drejtorit të institucionit, i cili ngarkon punonjësën përkatës për zgjidhjen dhe kthimin e përgjigjes të paraburgosurve dhe të dënuarve.

Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e kërkesave ose ankesave të të dënuarve dhe të paraburgosurve, në formë shkrese dhe elektronike. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit, si dhe procedura për kthimin e përgjigjes përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 50

Afatet e shqyrtimit të ankesave dhe të kërkesave (*Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008*)

Organet kompetente sipas këtij ligji shqyrtojnë ankesat dhe kërkesat sa më parë, por jo më vonë se 1 muaj nga paraqitja e tyre, përveç kur ka afate të posaçme me dispozita të veçanta.

I burgosuri ka të drejtë të ankohet në instancat më të larta të sistemit të burgjeve dhe, kur kjo ankesë nuk zgjidhet në rrugë administrative, apo ndaj vendimit të dhënë, i burgosuri mund t'i drejtohet gjykatës së vendit ku ndodhet institucioni.

Neni 51
Rregullat e disiplinës
(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Rregullat e disiplinës zbatohen në mënyrë që të stimulojnë ndjenjën e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të të paraburgosurit dhe të dënuarit. Ato hartohen në përshtatje me gjininë, moshën, gjendjen fizike, psikike, psikologjike të tij.

Për të miturit dhe personat e diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, personat që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose të abuzimit seksual zbatohet një regjim disiplinor lehtësues në përputhje me nevojat e tyre.

Rregullat që përbëjnë regjimin disiplinor lehtësues dhe procedurat për zbatimin e tij përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Neni 52
Shkeljet disiplinore
(Shtuar paragrafi i parë me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Masat disiplinore duhet të jenë forma e fundit e disiplinimit të sjelljes. Në rastet kur është e mundur, autoritetet e institucionit përdorin ndërmjetësimin për zgjidhjen e konflikteve mes të dënuarve dhe të paraburgosurve ose mes tyre dhe personelit të institucionit.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit nuk mund të ndëshkohen për një fakt që nuk është parashikuar shprehimisht si shkelje në këtë ligj, në rregulloren e burgjeve dhe rregulloren e institucionit.

Ndëshkimi mund të jepet vetëm pas dëgjimit dhe verifikimit të pretendimit të të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Ndëshkimet caktohen në përputhje me llojin dhe rëndësinë e shkeljes, qëndrimin e të paraburgosurit dhe të dënuarit ndaj saj, si dhe të dhënat individuale të tij.

Ndëshkimet zbatohen duke respektuar personalitetin e të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Neni 53
Masat disiplinore
(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

1. Për shkeljet disiplinore zbatohen këto masa:

- a) këshillim individual;
- b) Vërejtje në prani të të paraburgosurve dhe të dënuarve;
- c) Përjashtim nga veprimtari të veçanta, të përbashkëta deri në 10 ditë;
- ç) Përjashtim nga ajrosja në grup për jo më shumë se 20 ditë;
- d) Përjashtimi nga të gjitha veprimtaritë e përbashkëta deri në 20 ditë;
- dh)) Mosdhënia e lejes.

Ndaj të miturve dhe grave masat e parashikura në shkronjat “c”, “ç” dhe “d” mund të jepen deri në gjysmën e kohës së parashikuar. Për gratë shtatzëna ose që u është lënë fëmija, mund të zbatohen vetëm masat disiplinore të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të këtij neni.

Në rregulloren e burgjeve masat e mësipërme mund të diferencohen në varësi të llojit të institucionit, pa kaluar kufijtë maksimalë.

2. Masa disiplinore e përjashtimit nga veprimtaritë e përbashkëta dhe ajrosja në grup nuk mund të bëhet pa një dokument me shkrim, të lëshuar nga mjeku, që dëshmon se i paraburgosuri dhe i dënuari mund ta përballojë atë. I dënuari, ndaj të cilit merret kjo masë, i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm mjekësor.

3. Masat disiplinore të parashikuara nga shkronjat “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni, merren ndaj të miturit të dënuar ose të paraburgosur, vetëm pasi më parë janë zbatuar këshillimi individual ose vërejtja në prani të të dënuarve.

Masat disiplinore për të miturin zbatohen sipas parimit se masa disiplinore është formë e fundit e disiplinimit të sjelljes.

Neni 54

Organi kompetent për dhënien e masave disiplinore

(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Masat disiplinore të këshillimit dhe vërejtjes para të paraburgosurve dhe të dënuarve të tjerë jepen nga drejtori i institucionit.

Masat e tjera vendosen nga komisioni disiplinor, i përbërë nga drejtori i institucionit, në cilësinë e kryetarit, dhe përgjegjësi i sektorit ligjor, përgjegjësi i sektorit të sigurisë, përgjegjësi i sektorit të kujdesit social dhe specialisti i sektorit të kujdesit social që trajton të dënuarin në cilësinë e anëtarëve.

Mjeku merr pjesë në mbledhjet e komisionit disiplinor, sipas pikës 2, të nenit 53, të këtij ligji, pa të drejtë vendimmarrjeje. Ai harton në çdo rast një raport mjekësor ku shprehet mbi gjendjen shëndetësore të të paraburgosurit dhe të dënuarit. Ky raport mjekësor i shërben komisionit disiplinor për përcaktimin e masës disiplinore.

Komisioni disiplinor ngrihet dhe funksionon me urdhër të drejtorit të institucionit, i cili mbledh komisionin disiplinor jo më vonë se 48 orë nga momenti i konstatimit të shkeljes.

Neni 54/1

Procedura e dhënies së masave disiplinore

(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Komisioni disiplinor merr vendim për dhënien e masës disiplinore, pasi ka dëgjuar më parë personin ndaj të cilit ka një propozim për masë disiplinore, nëse ai dëshiron të shprehet.

Njoftimi i personit të interesuar ose refuzimi i tij për t'u shprehur përpara komisionit vërtetohet kundrejt nënshkrimit të të interesuarit dhe, në rastet e hezitimit të tij për të firmosur, me nënshkrimin e dy personave të tjerë nga stafi, që nuk janë të përfshirë në ngjarjen që ka shkaktuar propozimin për masë disiplinore.

I dënuari dhe i paraburgosuri mund të mbrohet vetë ose nga mbrojtësi i tij, kur e çmon të nevojshme, u garantohet e drejta për të thirrur dëshmitarë në emër të tyre ose për të kundërshtuar provat ndaj tyre u garantohet kohë e mjaftueshme dhe lehtësi për të përgatitur mbrojtjen e tyre.

I dënuari dhe i paraburgosuri kanë të drejtë të kenë përkthyes, nëse nuk mund të kuptojnë ose flasin gjuhën shqipe.

Organet kompetente i dorëzojnë të dënuarit ose të paraburgosurit një kopje të vendimit për marrjen e masave disiplinore.

Neni 54/2

Ankimi i masave disiplinore

(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

I paraburgosuri dhe i dënuari kanë të drejtë të apelojnë masën disiplinore pranë komisionit të apelit të masave disiplinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, brenda 15 ditëve, nga njoftimi i tij me shkrim për masën disiplinore të dhënë nga komisioni disiplinor.

Komisioni i apelit të masave disiplinore njofton me shkrim të dënuarin ose të paraburgosurin lidhur me vendimin e tij.

Masa disiplinore fillon efektin e saj nga momenti i marrjes së një vendimi nga komisioni disiplinor.

Masat disiplinore evidentohen në regjistrin e masave disiplinore, në dosjen psiko-sociale dhe në dosjen personale të të dënuarit. Ato konsiderohen të padhëna, në rast mospërsëritjeje për një periudhë 6-mujore për shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 53, dhe për një periudhë 1-vjeçare për shkronjat “c”, “ç”, dhe “d” të nenit 53.

Neni 55

Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

I paraburgosuri dhe i dënuari mund të vendoset nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë për një periudhë jo më të gjatë se 3 muaj, kur:

- a. rrezikojnë sigurinë ose prishin rregullin në institucion;
- b. pengojnë veprimtaritë e të paraburgosurve dhe të dënuarve të tjerë nëpërmjet dhunës dhe kërcënimeve;
- c. përpiqen të detyrojnë të paraburgosurit dhe të dënuarit e tjerë që t’ju nënshtrohen ose të përfitojnë prej tyre;
- ç. nxisin të tjerët të mos zbatojnë ose të shkelin rregullat individualisht ose në grup.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit nën regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, me urdhër të drejtorit të institucionit, i kufizohet vetëm pjesëmarrja në veprimtaritë e përbashkëta ose ajrosja në grup.

Në rast nevojë urgjente, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve urdhëron drejtpërdrejt për kalimin e përkohshëm të të paraburgosurit dhe të dënuarit në regjimin e mbikëqyrjes së veçantë, duke vënë menjëherë në dijeni për këtë prokurorin, i cili brenda 24 orëve, i paraqet kërkesën gjykatës, e cila me vendim konfirmon ose anulon masën e përkohshme.

Ndaj të paraburgosurit dhe të dënuarit, i cili gjatë regjimit të mbikëqyrjes së veçantë kryen shkelje të parashikuara në këtë nen, mund të shtyhet koha e regjimit deri në 3 muaj për çdo rast, duke u respektuar rregullat e marrjes së kësaj mase.

Neni 56

Përmbajtja e regjimit të mbikëqyrjes së veçantë

Regjimi i mbikëqyrjes së veçantë përmban kufizimet më të nevojshme për mbajtjen e rregullit dhe të sigurisë, për ushtrimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve dhe për rregullat e trajtimit të parashikuara në rregulloren e burgjeve.

Për çdo rast, shtrëngesat nuk kanë të bëjnë me kërkesat e higjienës, të shëndetit, të veshjes, të ushqimit, të pajisjeve, me mbajtjen, blerjen dhe marrjen e ushqimeve ose

objekteve të tjera të parashikuara nga rregullorja e institucionit, me leximin e librave, me praktikat fetare, me përdorimin e aparateve radio të tipit të lejuar, me ajrosjen, me bisedimet me avokatin mbrojtës, si dhe me bashkëshortët, fëmijët dhe për të miturit me prindërit.

Neni 57

Përdorimi i forcës fizike dhe i mjeteve shtrënguese

Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të paraburgosurit dhe të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatimin e urdhrave të dhëna.

Personeli, i cili për çdo lloj arsye ka përdorur forcën fizike ndaj të paraburgosurit dhe të dënuarve, duhet menjëherë të verë në dijeni me shkrim drejtorin e institucionit, i cili nga ana e tij bën kontrollin dhe siguron ndihmën shëndetësore të të paraburgosurit dhe të dënuarve dhe vetëm pas kësaj verifikon çështjen.

Mjetet e shtrëngimit fizik nuk mund të përdoren si ndëshkim, por vetëm në rastet që parashikohen shprehimisht në rregullore dhe për të shmangur përpjekjet për largimin nga institucioni, dhunën ndaj personave, dëmtimin e sendeve, si dhe për të garantuar shëndetin e vetë të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Përdorimi i mjeteve të shtrëngimit fizik duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe për kalimin për një periudhë mbi 72 orë duhet të merret miratimi i prokurorit.

Gjatë shtrëngimit fizik, i paraburgosuri dhe i dënuari duhet të jetë nën kontrollin e vazhdueshëm të shërbimit shëndetësor.

Neni 58

Llojet dhe natyra e forcës dhe mjeteve të shtrëngimit

Në rregulloren e burgjeve përcaktohen llojet, natyra e forcës dhe e mjeteve të shtrëngimit dhe rregullat e përdorimit të tyre me funksion parandalues dhe në përputhje me individualitetin e të të paraburgosurit dhe të dënuarit. Ndalohet përdorimi i mjeteve të forcës dhe atyre shtrënguese, që formojnë armë ose i lëndëve narkotike në kuptim të Kodit Penal, si dhe ato që kanë natyrë torturuese dhe hipnoze.

Policët e shërbimit brenda institutit nuk duhet të mbajnë armë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligjin “Për Policinë e Burgjeve”.

KREU II

LEJET, SHPËRBLIMET DHE NDRYSHIMI I GJENDJES CIVILE

Neni 59

Lejet shpërblyese

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Të dënuarit, të cilët respektojnë rregullat e disiplinës dhe rregulloren e brendshme të institucionit, që janë të motivuar për të marrë pjesë në programet rehabilituese e të riintegritimit dhe nuk paraqesin rrezikshmëri shoqërore, kanë të drejtë të marrin leje shpërblyese, por jo më shumë se 20 ditë në vit.

Për të dënuarit e mitur, kohëzgjatja e lejeve shpërblyese nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë për çdo rast të dhënies së saj dhe, në total, nuk mund të jetë më shumë se 45 ditë në vit.

Leja shpërblyese i jepet:

a) personave të dënuar deri në 3 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/4 e dënimit;

b) personave të dënuar nga 3 deri në 10 vjet burgim, pasi të kenë vuajtur jo më pak se 1/2 e dënimit;

c) Personave të dënuar mbi 10 vjet burgim, pasi t'u ketë mbetur për të vuajtur më pak se 5 vjet heqje lirie.

Leja shpërblyese në burgjet apo seksionet e sigurisë së lartë jepet vetëm me urdhër të Ministrit të Drejtësisë ose me autorizimin e tij nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve.

Brenda 7 ditëve nga marrja e kërkesës për leje, institucioni ku kryhet dënimi miraton lejen shpërblyese. Koha e dhënies së lejes përcaktohet sipas një grafiku të miratuar nga drejtori i institucionit që në fillim të vitit.

Në rast refuzimi të dhënies së lejes, i dënuari ose përfaqësuesi i tij ligjor ka të drejtë të bëjë ankim pranë Ministrit të Drejtësisë, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative brenda 5 ditëve dhe më pas ka të drejtë të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për leje.

Procedurat e dhënies së lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Drejtësisë.

Neni 60

Leje të veçanta

(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Drejtori i institucionit mund t'u japë të paraburgosurve dhe të dënuarve leje të veçantë, në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, apo të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje apo martesë si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit.

Leja e veçantë jepet deri në 48 orë dhe, me kërkesë të të dënuarit, mund të zgjatet edhe 24 orë të tjera, kundrejt dokumentacionit ligjor të paraqitur në institucion dhe për sa e justifikojnë rrethanat.

Në rast se dhënia e lejes refuzohet nga drejtori i institucionit, i burgosuri mund të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për dhënien e lejes.

Dhënia e lejes së veçantë i komunikohet menjëherë strukturave të Policisë së Shtetit, ku do të qëndrojë i dënuari.

Neni 61

Detyrimet gjatë lejes dhe përgjegjësia për shkeljet

I paraburgosuri dhe i dënuari është i detyruar të respektojë kohën e lejes, ta kryejë atë në vendin për të cilën i është dhënë, të respektojë të gjitha detyrat dhe kushtëzimet që i janë dhënë dhe të njoftojë institucionin për çdo shmangie të imponuar.

Për mos respektimin e rregullave të mësipërme drejtori i institucionit ndërpret lejen, ndërsa për rastet e tejkalimeve në kundërshtim me kriteret e neveve 59 dhe 60 të këtij ligji, kërkohet nisja e procedimit penal sipas nenit 323 të Kodit Penal.

Neni 62
Shpërblimet
(Shfuqizuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Neni 63
Ulja e dënimit
(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për riintegrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit.

Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.

Ulja e dënimit bëhet me vendim të gjykatës, në bazë të kërkesës së të dënuarit apo përfaqësuesit të tij, ose të drejtorit të institucionit.

Neni 64
Ndryshimet në gjendjen civile
(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Drejtoria e institucionit i evidenton, në një regjistër të veçantë, faktet e lindjeve, martesave apo vdekjeve të ndodhura në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale me burgim, si dhe informon autoritetet përgjegjëse, për të bërë shënimet përkatëse në regjistrin e posaçëm të gjendjes civile, në të cilin nuk pasqyrohet statusi i personit si i burgosur.

Drejtoria e institucionit duhet të njoftojë menjëherë autoritetet gjyqësore, zyrën përkatëse të gjendjes civile, familjarët dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për vdekjen e të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Në këto raste kufoma vihet menjëherë në dispozicion të familjarëve dhe, kur nuk ka të tillë ose kur refuzohet marrja, vendoset në varreza publike. Për vdekjen e të paraburgosurit dhe të dënuarit me shtetësi të huaj dhe për vendosjen e tij në varrezat publike njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme.

Neni 65
Depozitat

Shumat në para të të dënuarve depozitohen pranë zyrës së llogarisë në institucion dhe, kur janë mbi limitet e parashikuara në ligj, jashtë tij, duke i dhënë dokumentin përkatës sipas ligjit.

I dënuari mund të disponojë depozitën sipas ligjit dhe kriterëve të parashikuara në rregulloren e burgut.

KREU III TRANSFERIMET DHE LIRIMI

Neni 66

Rregullat e transferimit

(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Transferimet bëhen për arsye të rënda sigurie, kur rrezikohet jeta ose shëndeti i të dënuarit nga të tjerët, kur ka mbipopullim në institucion, për nevoja të hetimit dhe gjykimit, për shkaqe shëndetësore dhe familjare, si dhe kur për shkak të formimit profesional është i nevojshëm në një institucion tjetër si dhe në zbatim të urdhrit të ekzekutimit të prokurorisë për vendimet e formës së prerë të gjykatës.

Transferimet duhet të favorizojnë mundësi që të dënuarit ta kryejnë dënimin pranë vendbanimeve të familjeve të tyre.

Për personat e mitur që arrijnë moshën madhore dy muaj para lirimit të tyre, autoritetet kompetente duhet të shqyrtojnë, rast pas rasti, për mostransferimin e tyre në institucionet e vuajtjes së dënimit për të rritur.

Për t'u siguruar që transferimi i të dënuarve të huaj lehtëson riintegrimin e tyre dhe nuk shkel të drejtat e tyre themelore, duhen marrë parasysh mendimi i të dënuarve, lidhjet familjare, gjuhësore, kulturore, sociale e ekonomike dhe kushtet e burgjeve në shtetin ku ai do të vuajë dënimin, para marrjes së vendimit të formës së prerë.

Transferimi i të dënuarve dhe të paraburgosurve bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Të dënuarit duhet të transferohen së bashku me sendet vetjake.

Neni 67

Lirimi

(Hequr fjalia e fundit e paragrafit të parë me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Lirimi i të dënuarve bëhet kur përfundon ekzekutimi i vendimit të dënimit ose në bazë të ligjit, me vendim të organit kompetent. Administrata kryen veprimet me urdhër me shkrim të drejtorit të institucionit.

Për të dënuar që nuk kanë mjete financiare dhe veshmbathje, me urdhër të drejtorit të institucionit i jepet një ndihmë në sasinë dhe sipas kritereve të rregullores së burgjeve.

Në të gjitha rastet kur rezulton që i liruari do të hasë në vështirësi për kthimin në jetën e lirë, drejtori i institucionit njofton për këtë organet e pushtetit lokal, ku banon i dënuari për asistencë të mëtejshme.

Për të dënuarit e mitur është i detyrueshëm njoftimi paraprak i prindërve ose kujdestarit të tij.

Gjykata që ka dhënë vendimin, organet e policisë lokale dhe Ministria e Brendshme njoftohen menjëherë për lirimin e të dënuarit dhe në raste të veçanta edhe paraprakisht. Për shtetasit e huaj njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë.

Të liruarit i jepet një vërtetim lirimi në të cilin saktësohet kohëzgjatja e vuajtjes së dënimit, uljet dhe përfitimet që ka pasur për shkak të ligjit, si dhe kohëzgjatja e lloji i punës së kryer në institucion.

Me kërkesën e tij mund të jepet edhe vërtetim me të dhëna për aftësimin profesional të fituar, si dhe njoftime për sjelljen në burg.

PJESA E PESTË
SHQYRTIMI GJYQËSOR I ANKIMEVE DHE ROLI I AVOKATIT TË POPULLIT
(Ndryshuar titulli me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Neni 68
Ushtrimi i mbikëqyrjes
(Shfuqizuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Neni 69
Detyrat e prokurorit
(Shfuqizuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Neni 70
Format e mbikëqyrjes së prokurorit
(Shfuqizuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Neni 71
Kompetencat e gjykatës
(Hequr fjalët me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Gjykata, në territorin e së cilës ndodhet institucioni, shqyrton me një gjyqtar të gjitha rastet që përcaktohen shprehimisht në këtë ligj, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e të dënuarit, të cilat nuk janë zgjidhur nga institucioni mbi ankimin e të dënuarit me përjashtim të çështjeve për të cilat në Kodin e Procedurës Penale është përcaktuar kompetenca.

Neni 72
Shqyrtimi i çështjes nga gjyqtari
(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Gjyqtari shqyrton çështjen dhe merr vendime vetëm përse është ankuar ose kërkuar në seancë gjyqësore me pjesëmarrje të detyrueshme të drejtorit të institucionit ose përfaqësuesit të tij. Kur çështja nuk mund të shqyrtohet pa praninë e të dënuarit, seanca zhvillohet në mjedise të përshtatshme të institucionit ku ndodhet.

Në shqyrtimin e çështjes merr pjesë edhe avokati i kërkuar nga i dënuari ose i caktuar kryesisht për të dënuarit e mitur, ata që kanë shqetësime psikike, gratë me barrë ose fëmijë në gji, si dhe të dënuarit me shtetësi të huaj.

Neni 73
Shqyrtimi i ankimeve
(Shfuqizuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Neni 74
Ekzekutimi i vendimeve
(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Vendimet e formës së prerë, që jepen nga gjykata, kur nuk parashikohet ndryshe, ekzekutohen nga drejtori i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Neni 74/1

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues dhe kompetencat e tij
(Shtuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Avokati i Popullit, nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar, që vepron si strukturë e veçantë nën autoritetin e tij, mbikëqyr zbatimin dhe realizimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të dënuarve.

Mekanizmi Kombëtar ka këto kompetenca:

a) vëzhgon rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues;

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues.

Neni 74/2

Garancitë në veprimtaritë e Mekanizmit Kombëtar
(Shtuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Mekanizmit Kombëtar, gjatë ushtrimit të detyrës së tij, i garantohet:

a) marrja e çdo informacioni në lidhje me numrin e individëve që u është hequr liria, në vendet e privimit të lirisë, si dhe numrin e vendeve dhe vendndodhjen e tyre;

b) marrja e të gjithë informacionit për trajtimin e këtyre individëve, si dhe për kushtet e tyre të ndalimit;

c) hyrja lirisht në të gjitha vendet dhe mjediset ku është kufizuar liria e individit;

ç) kryerja e intervistave private, pa dëshmitarë, me individët që u është hequr liria, personalisht ose me një përkthyes kur është e nevojshme, si edhe me çdo individ tjetër që mund të japë informacionin e nevojshëm;

d) zgjedhja lirisht e vendeve që kërkon të vizitohet dhe e individëve që kërkon të intervistohet.

Neni 74/3

Format e mbikëqyrjes
(Shtuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)

Mbikëqyrja e Mekanizmit Kombëtar realizohet nëpërmjet:

a) pranimit të kërkesave ose ankesave nga të dënuarit ose të paraburgosurit me shkrim ose drejtpërdrejt;

b) marrjes së informacionit, ankesave ose kërkesave të të dënuarit, ose nga individë që kanë statusin e vizitorit apo të organeve shtetërore ose organizatave joqeveritare, të cilat kanë kontrolluar apo vizituar institucionin, sipas kompetencës që u njeh ligji, si dhe nga avokati i të dënuarit ose të paraburgosurit;

c) kërkit të informacioneve nga administrata e institucionit;

ç) verifikimit të dokumenteve, objekteve, pajisjeve ose mjedisëve, që kanë lidhje me të dënuarin ose me të paraburgosurin, brenda dhe jashtë institucionit.

Për realizimin e procesit të mbikëqyrjes, Mekanizmi Kombëtar mund të marrë edhe specialistë të fushave përkatëse. Në çdo rast dhe pavarësisht nëse konstatohen shkelje e parregullsi gjatë verifikimit, specialistët e këtij mekanizmi mbajnë procesverbal, i cili nënshkruhet nga drejtori i institucionit ose i ngarkuari prej tij, me të drejtën e pasqyrimit të vërejtjeve.

Neni 74/4

Mbrojtja e të dhënave personale
(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale marrin masa për zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke garantuar një nivel sigurie të plotë gjatë përpunimit dhe ruajtjes së tyre.

PJESA E GJASHTË
TRAJTIMI I TË PARABURGOSURVE
(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Neni 75

Mbrojtja shitesë e personave të paraburgosur
(Ndryshuar me ligjin nr.9888, datë 10.3.2008)
(Ndryshuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Rregullat në këtë pjesë të ligjit parashikojnë mbrojtje shitesë të personave të vendosur në institucione të paraburgimit ose seksione të paraburgimit.

Neni 75/1

Trajtimi i të paraburgosurve
(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Në asnjë rast të paraburgosurit nuk trajtohen si të dënuar, ose si persona që mund të dënohen në të ardhmen.

Personat e paraburgosur gëzojnë të gjitha të drejtat që gëzojnë edhe të dënuarit me burgim.

Brenda regjimit, të paraburgosurit u nënshtrohen të gjitha rregullave të brendshme të institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale.

Ndalohe mbajtja e të miturve në një dhomë me të rriturit, ose vendosja e të miturave vajza me të mitur djem në një dhomë. Të miturat vajza vendosen të ndara nga të mitur djem dhe mbahen vetëm nën mbikëqyrjen dhe kujdesin të personelit të së njëjtës gjini.

Gratë e paraburgosura vendosen në dhoma ose seksione të veçanta nga burrat dhe mbahen vetëm nën mbikëqyrjen e kujdesin të personelit të së njëjtës gjini.

Neni 75/2

Pranimi i të paraburgosurve në institucion
(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Në çdo rast të paraburgosurit mbahen në seksione të veçuara nga seksioni i të dënuarve me burgim.

Pranimi i të paraburgosurve bëhet në bazë të dokumentacionit, i cili përmban vendimin e gjykatës për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, procesverbalin e ndalimit ose të arrestimit në flagrancë, procesverbalin e kontrollit personal, formularin e identifikimit, me dy fotot dhe gjurmët e gishtërinjve, dokumentin e kontrollit mjekësor e certifikatën personale dhe dokumentin e identifikimit, pasaportë apo dokument identifikimi të përgatitur nga policia.

Lirimi i personave të paraburgosur bëhet vetëm me vendim të gjykatës ose të prokurorisë. Në rastet kur i paraburgosuri i liruar nuk ka mundësi strehimi ose transporti pranë familjes së tij, drejtori i institucionit, në bashkëpunim me institucionet vendore, si dhe organizatat e tjera, mundësojnë sistemimin dhe transportin e tij.

Në rast pamundësie objektive për t'u larguar nga institucioni pas lirimit, me kërkesën e tij, personi i paraburgosur mundëson strehimin në institucion, deri në përfundimin e pengesës për largim.

Neni 75/3

Të drejtat e të paraburgosurve

(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Personat e paraburgosur që ndodhen në institucionet e paraburgimit ose seksionet e paraburgimit gëzojnë të drejtat të përcaktuara në nenet 5, 11, 23-28, 30, 32-42, të këtij ligji, si dhe të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë seksion të ligjit.

Të paraburgosurit lejohen të informojnë menjëherë familjen për vendndodhjen e tyre. Atyre u krijohen të gjitha kushtet e nevojshme të takohen me familjarët, me përjashtim të rasteve kur kjo pengon ose nuk është në interes të zhvillimit të hetimit dhe gjykimit.

Drejtori i institucionit të paraburgimit kufizon të drejtën e të paraburgosurve për të pritur vizita, për korrespondencë apo për biseda telefonike, kur është e nevojshme, për kryerjen e veprimeve procedurale penale të urdhëruara nga organi procedues përkatës.

Në asnjë rast të paraburgosurit nuk detyrohen të punojnë. Nëse të paraburgosurit zgjedhin të punojnë, ata u nënshtrohen të njëjtave kushteve të punës si të dënuarit me burgim.

Neni 75/4

Këshillimi ligjor

(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Të paraburgosurit informohen në çdo rast për të drejtën për të përfituar këshillim ligjor.

Mjediset ku mbahen të paraburgosurit duhet të ofrojnë mundësinë që ata të takohen me mbrojtësit ligjorë dhe të përgatitin mbrojtjen për gjatë gjithë gjykimit.

Neni 75/5

Lejet e veçanta

(Shtuar me ligjin nr. 40/2014, datë 17.4.2014)

Të paraburgosurit nuk përfitojnë leje shpërblyese. Me miratimin paraprak të prokurorit dhe të drejtorit të institucionit, të paraburgosurit mund t'i jepet leje e veçantë për:

- a) lindje të fëmijës së të paraburgosurit;

- b) martesë e fëmijës, vëllait, motrës apo prindit të të paraburgosurit;
- c) vdekje e fëmijës, bashkëshortit/bashkëshortes, vëllait, motrës apo prindit të të paraburgosurit ose të bashkëshortit të tij.

Vërtetimi i fakteve juridike dhe identifikimi i personave të mësipërm bëhen në bazë të dokumenteve të lëshuara për këto raste nga institucionet përkatëse.

Neni 76

Aktet nënligjore zbatuese

Këshilli i Ministrave miraton rregulloren e burgjeve dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Rregulloret e brendshme të çdo institucioni miratohen nga Ministri i Drejtësisë, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e rregullores së burgjeve.

Ministri i Drejtësisë në zbatim të ligjit dhe rregullores së burgjeve nxjerr urdhrat dhe udhëzimet e nevojshme.

Deri në daljen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, mbeten në fuqi ato ekzistuese.

Neni 77

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Ligji nr.8328, datë 16.4.1998 shpallur me dekretin nr.2076, datë 30.4.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.11, faqe 379